

+



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 13  
Prishtinë, më 13.07.2021, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-506

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Hykmete Bajrami, Arta Bajraliu, Eman Rrahmani, Fadil Nura, Enver Haliti, Yllza Hoti, Albana Bytyçi, Bekim Arifi dhe Hajdar Beqa.

**Munguan:** Mirlinda Sadiku dhe Jasmina Dediq.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Antigona Ibraj, Mehmet Simnica dhe Fatlind Azizi.

**Të ftuar:** Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi; Yll Buleshkaj nga KQZ-ja dhe Haxhi Nimanaj nga Audit&Conto Auditori;

**Pjesëmarrësit tjerë:** Trim Berisha, Suzana Kasami, Fidan Kalaja dhe Arianit Abazi nga MAPL-ja; Emine Fazliu, Arian Haxha dhe Saranda Husaj-Baraliu nga ZKA-ja; Drenusha Sylja nga GP-LDK; Luljeta Tahiraj, Qazim Rrahmani nga Kuvendi i Kosovës; Leonora Bajrami nga KDI-ja dhe Aulona Sylaj nga Ekonomia Online.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2020. I ftuar, Ministri i MAPL-së z. Elbert Krasniqi;
3. Tërheqja e shortit lidhur me Auditimin e Raportëve Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, së subjekteve politike, për vitet 2018, 2019 dhe 2020;
4. Të ndryshme.

**Mbledhjen e kryesoi Hykmete Bajrami, Kryetare e komisionit, e cila pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.**

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2020. I ftuar, Ministri i MAPL-së z. Elbert Krasniqi;**

**Kryesuesja,** kaloi në pikën e dytë të rendit të ditës dhe ia kaloi fjalën deputetit raportues Eman Rrahmani. *(Fillimisht deputete raportuese ishte nënkryetarja e parë Arta Bajraliu).*

**Eman Rrahmani,** tha se raporti i auditimit ka disa të gjetura ku si deputete raportuese e ka përgatitur Arta Bajraliu, mirëpo unë do të bëjë prezantimin e përmbledhjes që ka përgatitur ajo. Një nga problematikat që në vazhdimësi përmendet në raportet e ZKA, në po thuajse në të gjitha institucionet publike ka të bëjë me kontrollet e brendshme. Përkundër që në këtë raport theksohet se ka përmirësime vazhdon të mbetet problematike. Kontrollet e brendshme mund të ndodhin edhe në raste kur pozitat e rëndësishme brenda institucionit janë të lira dhe nuk plotësohen për periudha të gjata. Për më tepër mungesa e një zyrtari të pasurisë ashtu sic edhe është cekur në raport mund të krijoj disa problematika brenda sistemit financiar edhe atij të funksionimit. Komunikimi jo i mirë ndër institucional dhe shpeshherë edhe komunikimi brenda njësisë të një Ministrie ka rezultuar me krijimin e problemeve të cilat mandej janë raportuar edhe si gjetje e auditori për faktin se një çështje e caktuar ose rekomandimet paraprake nuk janë trajtuar apo përfunduar. Gjetja e dytë e theksuar në raportin e ZKA, na tregon edhe për nivelin e komunikimit dhe të interesimit të personave kompetent për të përfunduar avancet e pambyllura. Rastet e tilla kanë ndikim në gjendjen apo paraqitjen e pasqyrave financiare në formën reale të tyre. Një menaxhim dhe funksionim i mirë dhe adekuat brenda një organizate ndodhë atëherë kur të janë krijuar kanalet e mirëfillta të komunikimit dhe kanalet e mbikëqyrjes dhe kontrollit. Sipas raportit të ZKA, dobësi të tilla kanë dërguar në gjetje të cilat përkthehen në rekomandim për vitin e ardhshëm. Është shumë e rëndësishme që të ngritet niveli i përgjegjësisë mbi shpenzimet e parasë publike. Llogaridhënia duhet të jetë pjesë e pandashme e punës. Raporti thekson se në 8 projekte të investimeve kapitale ku MAPL ishte bashkfinancuese së bashku me komunat, nuk janë përmblyllur si projekte duke ndikuar kështu në PFV në paraqitje jo të reale të gjendjes së organizatës. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka rol në menaxhimin dhe synimin e shtimit të vlerës së organizatës jo vetëm duke raportuar faktet, por edhe duke parandaluar ndodhjen e gabimeve, duke identifikuar fushat për përmirësim nëpërmjet zbatimit të praktikave më të mira profesionale. Për shkak të rëndësisë që ka, ky organ duhet të funksionojë në mënyrë që të bëhet kontroll i brendshëm dhe shqyrtime të raporteve të punës. Viti 2020 krahasuar me vitin 2019, 2018 është me një performancë më të dobët në aspektin e shpenzimeve buxhetore. Është shpenzuar vetëm 74% e buxhetit ndërsa nivel i ulët i shpenzimeve ka ndodhur edhe në kategorinë e investimeve kapitale ku janë shpenzuar vetëm 33% e mjeteve të parapara. Ky është një prezantim që e ka përgatitur deputetja raportuese, këtë raport nuk është paraqitur si e gjetur, pagesa e punonjësve që nuk e kanë vijuar punën, sidomos në veri. Gjithashtu pyetje për ZKA-në se a ka pasur letër menaxhmente për ministrinë.

**Kryesuesja**, ia kaloi fjalën Ministrin të MAPL-së.

**Ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi**, tha se bazuar në raportin e auditorit ka pasur opinion të pamodifikuar mbi pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020. Sipas opinionit, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Megjithatë ky raport ka edhe të gjetura dhe rekomandime, që tani do t'i specifikoj. Një rekomandim vetëm se është adresuar, me marrjen e detyrës e kemi bërë përgatitjen e kontrollit të brendshëm, pasi kemi funksionalizu Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Për mua ishte e pajustificueshme që të mos funksionalizohej kjo gjë. Sa i përket tre të gjeturave, ne kemi hartuar planin e veprimit dhe tani ka filluar adresimi i tyre. Bëhet fjalë për rekomandimet për zyrtarin e pasurisë dhe tjetra për bartjen a pasurisë nga MAPL-ja. Për të parën me vendim të zv. Sekretarit më datë 26.01.2021 është transferuar përkohësisht zëvendësuesi i zyrtarit të pasurisë në departamentin përgjegjës, një tjetër është duke ndjekur trajnimet është duke i ndjekur në SIMFK nga MF-ja. Te çështja e dytë avancet e pambyllura nga vitet paraprake ku kishte paraqitur avance të paarsyetura për udhëtime zyrtare nga vitet 2010-2014, shpresojmë që këtë ta adresojmë këtë vit me ndihmën e Thesarit duke krijuar një trup verifikues që të analizohen të gjitha dokumentet dhe të adresohen këto çështje, nuk janë përdorur linjat e duhura buxhetore dhe për këtë shkas në sistem kanë mbetur të pambyllura. Kam marrë vendim që të gjitha shpenzimet e kabinetit të publikohen në baza javore dhe ato të ministrisë në baza mujore, kjo për qëllim që të merret si shembull i mirë nga komunat. E kemi zgjidhur edhe problemin e punonjësve të cilët nuk kanë ardhur në punë por janë paguar, disa duke i transferuar në institucione lokale në veri dhe disa të tjerë në qendër. Ka pasur një thirrje publike për investime kapitale e cila është hapur pasi është anuluar një e vjetër, që i mundëson që të gjitha komunave të jenë të barabarta në aplikim. Gjatë kësaj jave do të nënshkruaj kontrata me disa komuna.

**Kryesuesja**, pyeti zyrtarët e ZKA-së se a kanë diçka për të shtuar.

**Zyrtarja e ZKA-së**, tha se vlen të ceket se institucioni është pajtuar me të gjitha rekomandimet. Ne i kemi dërguar edhe letër menaxhment kësaj ministrie, por që ajo është një letër të cilën ne e përcjellim vetëm te institucioni përkatës, sipas standardeve paraqiten disa çështje më të vogla, në qoftë se janë të shpeshta atëherë përmendën në raportin e vitit të ardhshëm.

**Kryesuesja**, tha se rreth çështjes të punonjësve që nuk vijojnë punën por paguhen, ka raste të tilla edhe sot nëpër ministri. Nuk ka ndodhur vetëm në të kaluarën, por është si rrjedhojë e Marrëveshjes së Brukselit si arsye e integritit të komunitetit serb nëpër institucione publike. Çështja është më shumë politik, për atë edhe nuk e kanë përmendur ZKA-ja. Nuk e kuptoj se përse ka nevojë për avance të mbyllura. Në qoftë se zyrtarët humbin faturat atëherë duhet të i ndalet ajo shumë nga paga.

**Eman Rrahmani**, tha se për atë ka qenë e paarsyeshme humbja e milionave euro nga punonjës të tillë që nuk kanë shkuar kurrë në punë dhe sidomos në këtë qeveri kur qeverisim ne si LVV. Asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk të obligon të paguash dikë pa shkuar në punë fare. Nuk mund të mohosh institucionet e të paguash nga to. Unë i përgëzoj ministrin për eliminimin e këtij problemi dhe kudo ku ka probleme të tilla duhet të evitohen. Kushdo që nuk shkon të punoj, nuk duhet paguar. Ministër thatë që keni anuluar një thirrje dhe pastaj e keni hapur një të re me kritere të reja, në qoftë se mundesh të na tregosh ato kritere që të

mos kemi diskriminim të komunave apo aplikuesve të tjerë. Jam në dijeni rreth letër menaxhmenteve, dhe ju duhet të na dërgoni pasi që jemi të interesuar t'i shohim të gjeturat si komision. Mund të na dërgoni në mënyrë elektronike për çdo rast.

**Kryesuesja**, tha se askush nuk po e arsyeton rastet e tilla të komunitetit serb që nuk punojnë por paguhen, por raste të tilla ka pasur edhe në Qeverinë Kurti 1, raste të tilla ka edhe sot. Çështja është më shumë politike dhe uroj që sa më shpejt të zgjidhet. Tani MAPL-ja e ka pasur më të lehtë sepse i ka integruar në pushtetin lokal nëpër komuna, por ka raste në ministri të tjera ku nuk mund të rivendosen diku. Ndihe mirë që nuk ka të gjetura rreth kodit për rimëkëmbje ekonomike për komunat gjatë pandemisë.

**Ministri**, tha se e ka lexuar raportin dhe listën e pagave, nuk është e drejtë që dikush të paguhet pa punuar. Në ministri ka hapësira të mjaftueshme ku do të mund të vendoseshin ata që dëshirojnë të punojnë. Sa i përket thirrjes socio-ekonomike ishte rreth 1.5 milionë euro, me kritere që nuk specifikohet as maksimumi dhe minimumi i projekteve që do të financohen dhe tjetër kriter për komunat që kanë shpenzuar 50% të buxhetit iu shtoheshin 20 pikë. Është hapur edhe një thirrje me 500.000 euro për projektet specifike për komunat infrastrukturore për komunitetet dhe personat me nevoja të veçanta.

**Hajdar Beqa**, tha se ministri ishte i qartë rreth raportit të auditimit. Kam disa pyetje, si për shembull thuhet këtu se zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar, kanë qenë katër të tilla por këtu thuhet që një nuk është zbatuar. A janë mbyllur këto avance apo nuk janë mbyllur. Në qoftë se janë mbyllur mirë, por në qoftë se jo, a janë këta zyrtarë me avance të 2010-2014 ende pjesë e ministrisë. A ka plan të veprimit rreth zbatimit të rekomandimeve për vitin 2020. Këtu po thuhet se është zbatuar rekomandimi, por është përsëritur e njëjta gjë. Gjithashtu pyeti edhe për komitetin e auditimit.

**Ministri**, tha se gjithsej kanë qenë katër rekomandime. Njëri prej tyre ka qenë në vullnetin ekskluziv të ministrit, apo Komiteti i Auditimit. Për mua ka qenë e papranueshme që ministria të funksionoj pa këtë komitet. Këtë vetëm e kam adresuar dhe zgjidhur. Te çështja e avanceve, ato janë mbyllur, por nuk janë mbyllur nga vijat specifike buxhetore që pastaj në thesar ka rezultuar si e tillë. Për më tepër do ju flet sekretari, zyrtari për pasuri mungon si staf dhe jemi në procedurë të rekrutimit. Të gjitha këto rekomandime të këtij viti jam i bindur që vitin e ardhshëm nuk do t'i kemi.

**Hajdar Beqa**, tha se edhe këto ishin të qarta. Por këtu thuhet që te projektet me komunat janë pranuar, por teknikisht nuk ishin në përfudnime. Këtë e shoh si një lloj neglizhence në koordinim mes nivelit qendror dhe lokal, sepse në bazë të raportit del që komisioni për pranim teknik e ka bërë pranimin teknik.

**Kryesuesja**, pyeti sekretarin e MAPL-së, rreth mbylljes së avanceve nga vijat joadekuate, sepse zakonisht avancet janë të hapura kur ka mungesë të faturave për arsyetimin e shpenzimeve. Në qoftë se janë mbyllur avancet por nuk janë bërë në vijat adekuate, i bie që nuk kanë faj zyrtarët por është çështje e Drejtorisë për Financa, në qoftë se nuk keni pasur mjete për avance dhe i keni marrur nga mallrat dhe shërbimet.

**Trim Berisha, u.d. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së**, tha se mjetet janë kthyer. Nuk ka zyrtarë që ka marrur mjete dhe nuk i ka kthyer, por kur janë regjistruar të dhënat në sistem nuk janë bërë në linja të duhura buxhetore edhe në bankë Avancet janë të mbyllura. Mirëpo kur është bërë mbyllja e avanceve në sistem edhe në bankë nuk është bërë transferi i duhur

dhe ka mbetur te gjendja e përgjithshme të pabarazuara në linjat buxhetore. Do të duhej që në 2020 t'i korrigojmë por përshkak të pandemisë kemi mbetur pas. Tani së bashku me bankën tonë NLB dhe Thesarin do t'a korrigojmë avancet.

**Hajdar Beqa**, pyeti rreth mjeteve që janë kthyer me kohë por nuk kanë shkuar në vijë të duhura.

**Trim Berisha**, tha që edhe raporti i auditimit ka konstatuar këto të gjetura, mirëpo ato janë adresuar. Në mungesë të zyrtarit të pasurisë nuk janë regjistruar si duhet. Edhe komunat duhet të marrin përsipër regjistrimin e këtyre pasurive, pasi që ne nuk kemi ndonjë mjet obligues që komunat ta bëjnë regjistrimin. Neve në një vit na ishte dhënë vërejtje nga auditorët se përse i kemi fshirë pasuritë e nuk i kanë pranuar komunat. Ne realisht ne nuk guxojmë që t'i fshijmë, por do të punojmë me komunat që të regjistrohen këto pasuri.

**Fadil Nura**, tha se mua po më intereson një pjesë e përgjegjësisë së MAPL-së, ajo që u përmend këtu mu duk si vetëlavdërim, po më intereson se MAPL-ja çfarë përgjegjësi dhe si punon me vendimet e asambleve komunale e sidomos te komunat në veri, e dyta a jeni të informuar për të dhënat në terren për investimet e Serbisë. A po bëhen këto investime duke e respektuar Pakon e Ahtisaarit apo legjislacionin në fuqi apo jo. A e keni informuar qeverinë rreth këtij procesi. Unë mendoj që këto janë problemet kryesore, sa i përket atij zyrtarit është çështje më e vogël dhe nuk është ndonjë sukses i madh.

**Ministri**, tha se në të 38 komunat e Kosovës, të gjitha vendimet që i marrin kuvendet komunale e që duhet të kalojnë në ministrinë tonë, ato dërgohen me kohë dhe ne kujdesemi që zyrtarët përmes pjesëmarrjes fizike apo virtuale, t'i dëgjojnë vendimet tona sa i përket ligjshmërisë. Është pak e vështirë që ti kthehet përgjigja shumë shpejt të gjithë asambleve komunale, për këtë jemi edhe në plotësim-ndryshim të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, pasi ka disa afate që janë të shkurtra dhe pastaj ne po duhet që të padisim komunat për vendimet e paligjshme. Të gjitha komunat edhe në veri i nënshtrohen këtij procesi, kemi një përqindje të lartë të zbatueshmërisë. E kam adresuar në Ministrinë e Drejtësisë, ku ka pasur disa vendime të paligjshme nga komunat në të cilën u janë adresuar. Po mundohemi që të adresojmë edhe nëpërmjet platformës së e-komuna, të rritet llogaridhënia dhe të gjitha të dhënat e nismave të komunave mund t'i qasen edhe qytetarët, kështu rritet presioni publik. Momentalisht nuk kemi një mjet apo organ që i detyrojmë komunat për vendimet tona, por e vetmja mundësi mbetet nëpërmjet avokaturës së shtetit.

**Fadil Nura**, pyeti prapë rreth çështjes së ndërtimit të shëpive në veri?

**Ministri**, tha se nuk ka pranuar ende asnjë vendim prej marrjes së detyrës sime. Nuk kam informacione për më tepër.

**Fadil Nura**, pyeti se nuk jeni interesuar për këtë çështje fare?

**Ministri**, u përgjigj që kjo çështje bie më shumë në kompetenca të inspektoriateve të tjera dhe jo në portofolion e ministrit. Unë e kam përgjegjësi për të kontrolluar ligjshmërinë dhe pastaj kompetencat kalojnë në organe tjera. Në Komunën e Graçanicës e kemi rastin kur ligji obligon komunat që ku janë 10% e qytetarëve të komuniteteve jo shumicë të kemi edhe nënkryetari i komunës shtesë, ku në Graçanicë kemi 10% të qytetarëve shqiptarë dhe komuna është e obliguar që të ketë nënkryetarin shqiptar. Komuna nuk e ka zbatuar këtë vendim dhe unë i kam dërguar një shkresë me afat 5 ditore që të merret vendimi për emërimin e

nënkryetarit shqiptar. Në qoftë se ai nuk do bindej, do të suspendohej. Por, brenda afatit ai ka kthyer shkresën dhe asambleja komunale është duke e sabotuar duke e shtyrë pafundësisht seancën. Edhe këtë e kemi sqaruar dhe shumë shpejt do të zgjidhet.

**Fadil Nura**, tha përsëri se duhet të njoftohet kryeministrin dhe qeverinë për ndërtimet në veriun e Kosovës, nuk e di se a janë ndërtuar ligjërisht apo jo, por duhet të interesoheni për këtë gjendje.

**Ministri**, tha se kemi kërkesa në mënyrë të vazhdueshme për pranimin e donacioneve, ne i përcjellim këto donacione në komunë. Kam pasur kërkesa për të furnizuar me karburante shkollat në muajin mars, dhe unë këtë çështje e kam doëzuar te ZKM-ja, për të shikuar ligjshmërinë. Kam kërkuar pastaj nga Dogana që të bëj kontrollimin e këtij donacioni, pasi më është dukur pak e pazakonshme që ai donacion të pranohet në mars.

**Kryesuesja**, tha se rreth ligjshmërisë së vendimeve, kur bëhet verifikimi i atyre ligjshmërive dhe ministrive të linjës është pak jashtë raportit të auditorit. Në vitin e kaluar ka ndodhur që disa komuna të ndëshkohen me grantin e performancës për shkak se ministrinë e linjës janë vonuar më shumë se 15 ditë në dhënien e vendimeve për asambletë komunale, këtë pushteti lokal e ka marrur si negativ. Komunitat kanë rezistuar dhe kritikuar ministrinë se si mundën që të shenjohen si negative, kur problemi ka qenë te vonesa e ministrisë. Ndërkohë që MAPL-ja ka thënë që përgjegjësia ishte e ministrive të linjës. A keni menduar që ky afat 15 ditor të shtohet ose a keni brenda ministrisë ndonjë njësi e cila në vazhdimësi i bën presion këtyre ministrive të linjës. Ne e dimë që komunitat kanë buxhet të vogël, prandaj si mendoni për planet e ndryshimit rreth kësaj çështjeje.

**Ministri**, tha se njëri nga kapitujt ku duhet të fokusohemi është kjo. Ne do të shikojmë sepse jemi duke punuar mbi plotësim-ndryshimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, pasi që ka shumë mangësi. Te granti i performancës është shumë i rëndësishëm dhe vitin e ardhshëm do të tentojmë ta rrisim dyfish shumën e këtij granti.

**Albana Bytyçi**, tha se i intereson çështja e ndarjes së pakos emergjente. Nuk e kanë kategorizuar implementimin për kategorinë prodhuese. Duhet ndarë një buxhet specifik për komunitat, gjë e cila nuk është saktësuar. Kur ka hapësira të tilla dihet se çfarë ndodh aty. Doja më shumë informacione rreth kësaj çështjeje.

**Ministri**, tha se si MAPL kemi grantin e performancës dhe fondi për financimin e projekteve me strukturë socio-ekonomike. Domethënë pakoja emergjente, nuk ka pasur asgjë të bëj me ministrinë tonë, por ka kaluar direkt me MF, prandaj nuk kemi pasur asnjë obligim.

**Kryesuesja**, tha se kriteret janë përcaktuar nga MAPL-ja.

**Trim Berisha**, tha se në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike kemi dy të tilla. Është pakoja që u përmend nga kryetarja që ka ndodhur vitin e kaluar, ku ne si ministri i kemi përcaktuar kriteret dhe ia kemi dërguar qeverisë, pastaj MF-ja i ka transferuar mjetet. Ndërkaq pjesa tjetër është, ajo marrja e një shume të caktuar të grantit prej komunave dhe ajo pjesë ka mbetur që në këtë vit të rishpërndahen rreth 7 milionë euro, mirëpo që ka mbetur që MF-ja të përcaktoj edhe kriteret edhe transferimin e mjeteve.

**Bekim Arifi**, pyeti rreth punësimit në MAPL lidhur me 10% e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, sa janë të punësuar nga këto komunitete në ministrinë tuaj dhe si është gjendja e tyre.

**Ministri**, tha se në qoftë se e ke fjalën për stafin civil, nuk ka asnjë të punësuar nga këto komunitete, numri i shërbyesve civil arrin në 129. 11 prej tyre janë nga komunitetet, 9 janë serb dhe 2 janë turq. Ju keni plotësisht të drejtë që në 10% në çdo institucion duhet të përfaqësohen komunitetet pakicë. Si qeveri kemi një plan që punësimi të jetë në proporcion me numrin e përqindjes së popullsisë. Nuk është lehtë të bëhet, por me një strategji të duhur besoj që do të bëhet e mundur.

**Eman Rrahmani**, pyeti se a është plotësuar norma e punonjësve me aftësi të kufizuara, që në këtë rast i bie të jenë së paku 2 të punësuar. Rreth punonjësve që paguhen pa shkuar në punë, vetëm dua t'i rikujtoj mbi 10 milionë euro janë shpenzuar për këto paga, ky problem nuk duhet të përsëritet. Kanë kaluar shumë vendime që janë marrur më herët që i kanë dëmtuar të gjitha komunat, jo vetëm ato në veri. Besoj që tani me një ministër si Elberti, situata është pak më ndryshe. Shumica e vendimeve të paligjshme nuk janë kthyer nga kjo ministri më herët dhe e di që nuk do t'i lejoj ministri i tanishëm këto keqpërdorime.

**Kryesuesja**, tha se raporti ishte jashtëzakonisht i mirë dhe të gjeturat ishin të pakta. Por performancën e ministrit e shohim në raportin e rradhës.

**Fadil Nura**, shkurtimisht tha se nuk dallojnë shumë, por ndryshon qasja që unë e përdori me argumente dhe jo me fjalë të pabaza. Dua të jem konkret, unë thashë që të punësuarit nuk janë problem i madh në krahasim me atë se çfarë po ndodhë në veri. Jemi të saktë sepse jemi kundër shkeljes së ligjit, por që dy vjet po ndërtohen ato ndërtesa në veri. Prandaj ministri do të duhej të ishte në dijeni, më befasoj mendimi i ministrit. Duhet t'i shtoni kapacitetet, nuk ka nevojë që të shtohet afati i 15 ditëve. Fuziononi dhe rriteni kapacitetet, jepni vendimet komunës. Ndryshimi i ligjit është politikë e gabuar.

**Ministri**, tha se te plotësim-ndryshimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dua të sqarohem se ka pasur tendenca që të i jepet një konotacion negativ. Është bërë një vlerësim i këtij ligji në vitin 2018 dhe ka evidentuar disa sfera ku duhet që të bëhen ndryshime. Në takimet e rregullta me kryetarët e komunave diskutojmë se çfarë duhet të ndryshohet që të i lehtësohet puna komunave. Po mundohemi që të gjitha kërkesat t'i vlerësojmë. Ka shumë raste më herët ku kanë kaluar me heshtje administrative, ku kanë hasur pastaj në probleme.

**Kryesuesja**, tha se kur ta përgatisni planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve dhe të gjeturave, është mirë që të dërgohet tek deputetët. Ajo tha që meqë nuk ka shumë të gjetura dhe nuk ka rekomandime shtesë nga deputetja raportuese për ta dërguar në seancë plenare, propozon që të mos shkoj për trajtim në seancë.

### *Përfundim*

*Komisioni vendosi njëzëri që shqyrtimi i “Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2020” të mos dërgohet në seancë plenare.*

### **3. Tërheqja e shortit lidhur me Auditimin e Raporteve Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, së subjekteve politike, për vitet 2018, 2019 dhe 2020;**

**Kryesuesja**, tha se sot komisioni do të bëj tërheqjen e shortit lidhur me auditimin e Raporteve Vjetore Financiare dhe raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, së subjekteve politike për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Vetëm t'iu informoj që sot këtu i pranishëm është edhe menaxheri i kontratës, z. Fehmi Pireva. Kam diskutuar edhe me koordinatoren, Antigonen dhe me Mehmetin, nuk është e lehtë, pasi që është e gjetur nga raporti i progresit që nuk po auditohen subjektet politike. Ju e dini që është menaxhuar më herët nga stafi i kuvendit, por i kemi disa probleme, problemi te fondi i demokratizimit ndahet sipas koalicioneve parazgjedhore dhe partive që kanë fituar ulëse në kuvend. Te termat e referencës, është shënuar që do të auditoj koalicionet, sipas të dhënave nga KQZ-ja. PAN-i shembull në vitin 2018, mënyra se si është ndarë pastaj në mes partive është çështje e tyre. Tjetër problem është përzgjedhja e shortit, sipas Antigones dhe Mehmetit, këta i kanë përgatitur disa scenario se si mundet të tërhiqet shorti. Por e shohin pak problematike edhe interpretimin dhe tërheqjen e shortit nga ana jonë. Kuvendi ka mundur që të i zgjedh edhe 20 auditorë, të cilët kishin konkuruar në mënyrë individuale. Sipas interpretimit të stafit, tërheqja e shortit vlen vetëm kur do të kishim të bëjmë me auditorë individual, ndërkaq te kompanitë e auditimit të mos i bëjmë presion që të shkoj të auditoj këtë parti ose tjetrën parti. Përgjegjësia këtu është e kompanisë, tani ne kemi mundësi që të tërheqim shortin ose të vendosim në përgjegjësi të kompanisë që të caktoj auditorët vet. Nëse ne shkojmë me short, ne po rrezikojmë të shkelim edhe një nen të ligjit, ku thotë që një auditor nuk guxon të auditoj një subjekt politik dy vite rradhazi. Tani kjo ka vlejtur po të kishte auditim vit për vit, por e dimë që kjo ka dështuar. Në këtë kombimin një auditori do t'i bie që të auditoj një parti politike për dy vite ose më shumë dhe druaj se do të kritikohemi. Por sikur të kishim pasur auditim për vitin 2020, ne do t'a aranzhonim shortin që auditorët të mos mund të auditonin një parti për dy vite. Ndoshta është më mirë që të lihet në kompetencë të kompanisë, sepse edhe po të përcaktojmë shortin, ne nuk kemi mundësi që të i përcjellim gjatë procesit. Po e hapi diskutimin për këtë çështje, njëfarë lloj konflikti i interesit po e dimë se cili auditor do të auditoj partitë tona.

**Hajdar Beqa**, tha se këto janë procedura teknike dhe realisht kopmania fituese ka 3 vite, ne i kemi dy rrugë, sipas rekomandimit që e thatë ju që ta lëmë në kompetencë të auditorëve, ose rruga tjetër me kombinim të përzier. Megjithatë mesa po e shoh më e shkurt qenka me e vendos në diskrecion të kompanisë së auditimit.

**Kryesuesja**, tha se edhe ZKA-ja e ndryshon ekipin e auditorëve, në qoftë se një vit e ka audituar MINT-in, vitin tjetër e dërgojnë në një organizatë tjetër buxhetore. Kjo për të mos krijuar raporte afërsie, ky do të auditoj tre vjet përnjëherë. Ja bëjmë si të duani. Ne paskemi të ftuar edhe përfaqësues nga KQZ-ja dhe kompania private dhe menaxheri i kontratës.

**Fehmi Pireva, Menaxheri i kontratës**, tha se një zgjidhje gjendet, por problemi është si të rrimë në kontura të kornizës ligjore edhe të termeve të referencës. Kjo është e rëndësishme shumë, pasi që neve pastaj na krijohen precedentë edhe për vitet e ardhshme. Në termet e referencës që Drejtoria e Prokurimit është dashur të bëj kujdes. Ligji po e specifikon shumë mirë, së paku 10 auditorë. Është dashur të kërkohet një numër më i madh i auditorëve për



këtë auditim. Në qoftë se ne shkojmë ashtu mos po krijojmë ndonjë precedent për të ardhmes. Është përgjegjësi e kompanisë rreth numri të auditorëve.

**Kryesuesja**, tha se tani më kompania ka fituar tenderin dhe janë nënshkruar kontrata, vetëm ta dimë që është e gjetur e raportit e progresit që kuvendi po dështon me auditimin e subjekteve politike. Ne e dimë që me vetëm dy auditorë aplikonin kompanitë, është shumë e vështirë që të gjejmë një kompani me numër të madh të auditorëve. Nuk mund të kthehemi mbrapa, ju që e kryeni pagesën duhet të shikoni punën dhe besoj që në kontratë ka penallti të ndryshme. Por precedentë nuk do të linim të krijohej, pasi që stafi mbetet i njejtë edhe vitet e ardhshme. Arsyeja është të mos krijohen relacionet, ne nuk mund të garantojmë asgjë, por as ne nuk i njohim. E kam thënë edhe më herët, ne duhet që kur të plotësohet-ndryshohet Ligji i ZKA-së, ne nuk do të merremi më me këtë çështje. A keni propozime.

**Enver Haliti**, tha se në qoftë se Antigona dhe Mehmeti mund të na ndihmojnë, nëse kanë ndonjë mendim, përndryshe kompanisë i bie që të angazhoj auditorë të ri.

**Kryesuesja**, tha se nëse ne hedhim shortin atëherë janë vetëm auditorët që janë përcaktuar më herët.

**Eman Rrahmani**, tha se çështja qenka problematike, por në bazë të kësaj ne nuk kemi përse të hedhim short. Vet numri i vogël i auditorëve e pamundëson një gjë të tillë. Këtu jemi para aktit të kryer. Specifikacionet e tenderimit është dashur të analizohen pak më mirë. A ekziston nga kompania që të ndryshohen auditorët, që çdo vjet të ndryshohen e të mos bie i njejtë auditor për të njejtin subjekt politik.

**Kryesuesja**, tha se kompania sipas dokumentacionit, ka aplikuar me 10 auditorë me emra dhe mbiemra dhe me certifikata, dhe e ka fituar tenderin në bazë të këtij dokumentacioni. Në qoftë se kompania del jashtë kësaj atëherë është shkelje.

**Yll Buleshkaj, përfaqësues i KQZ-së**, tha se është kërkesë ligjore që të mos ketë një auditor të auditoj të njejtën parti për dy vjet, por duhet ta kemi parasysh që ndoshta do të ishte më mirë që kompania të përzgjedhë auditorët nga viti në vit, pasi që i kanë edhe auditorë e vet. Por këta që të sigurohen që auditorët të mos auditojnë në dy vite një subjekt politik.

**Kryesuesja**, tha qenka në kontratë hedhja e shortit. Qenka e njejtja kompani që e ka bërë auditimin edhe më herët.

*Hedhjen e shortit e bënë Fatlind Azizi dhe Drenusha Syla, staf mbështetës i komisionit.*

#### Grupi 10 – Auditori 4

Haxhi Nimanaj	Jedinstvena Goranska Partia		2018
	Partia Liberale Egjiptiane		2019
	Partia e Ashkalinjeve për Integrim		2020

**Grupi 3 – Auditori 8**

<b>Muhamet Feka</b>	LVV; Demokratska Stranka Boshnjaka; Demokratska Stranka Vatan; Ujedinjene Stranka Boshnjaka		<b>2018</b>
	LVV; Partia Demokratike e Ashkalinjeve Kosovës		<b>2019</b>
	Partia Social Demokrate; Srpska Lista		<b>2020</b>

**Grupi 1 - Auditori 2**

<b>Elmije Osmani-Shatri</b>	NISMA; Partia e Drejtësisë; Lëvizja për Bashkim; Alternativa Demokratike e Kosovës; AAK; PDK; Partia e Ballit; Partia Shqiptarte Demokristiane e Kosovës; Samostalna Liberalna Stranka		<b>2018</b>
	PDK; Partia e Drejtësisë; Alternativa Demokratike e Kosovës; NISMA; Republikanët e Kosovës; AAK; Lëvizja për Bashkim; Partia Demokristiane e Kosovës; Nova Demokratska Stranka		<b>2019</b>
	LDK; Partia Liberale Egjiptiane		<b>2020</b>

**Grupi 4 – Auditori 5**

<b>Besa Sahitaj-Berisha</b>	Srpska Lista		<b>2018</b>
	Balli Kombëtare i Kosovës; Demokratska Stranka Boshnjaka; Demokratska Stranka Vatan, Ujedinjene Stranka Boshnjaka		<b>2019</b>
	Inciativa e Re Demokratike e Kosovës; LVV		<b>2020</b>

**Grupi 5 – Auditori 3**

<b>Njazi Jakupi</b>	Partia e Ashkalinjeve për Integrim		<b>2018</b>
	Partia e Ashkalinjeve për Integrim		<b>2019</b>
	Partia e Bashkuar e Romëve e Kosovës		<b>2020</b>

**Grupi 9 – Auditori 1**

<b>Ymer Shatri</b>	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës		<b>2018</b>
	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës		<b>2019</b>
	Nova Demokratska Stranka		<b>2020</b>

**Grupi 6 – Auditori 9**

<b>Sebahata Hasani</b>	Partia Demokratike e Askalinjëve të Kosovës		<b>2018</b>
	Jedinstvena Goranska Partija		<b>2019</b>
	AAK		<b>2020</b>

**Grupi 2 – Auditori 7**

<b>Fatmir Mehmeti</b>	LDK; Alternativa Demokratike e Kosovës; Aleanca Kosova e Re; Nova Demokratska Stranka		<b>2018</b>
	LDK; Aleanca Kosova e Re; Samostalna Liberalna Stranka		<b>2019</b>
	PDK; Jedinstvena Goranska Partija		<b>2020</b>

**Grupi 7 – Auditori 6**

<b>Shaban Muharremi</b>	Kosova Demokratik Turk Partisi		<b>2018</b>
	Srpska Lista		<b>2019</b>
	Demokratska Stranksa Bonshnjaka; Ujedinjena Stranka Boshnjak; Demokratska Stranka Vatan		<b>2020</b>

**Grupi 8 – Auditori 10**

<b>Mexhid Aliu</b>	Partia Liberale Egjiptiane		<b>2018</b>
	Kosova Demokratik Parti		<b>2019</b>
	Aleanca Kosova e Re ; Partia e Drejtësisë ; NISMA		<b>2020</b>

## *Përfundim*

*Komisioni u pajtua dhe miratoi të gjithë procesin e shortit të hedhur nga stafi mbështetës i komisionit.*

### **4. Të ndryshme**

**Kryesuesja**, tha se duhet caktuar një rend dite për mbledhjen e radhës, edhe pse është Festa e Bajramit, atëherë duhet koordinuar që pas ditës së festës, deputetët të mos jenë të angazhuar me ndonjë komision tjetër. E kemi me opinion të kualifikuar MPB-në, mundemi ta thërrasim kopmaninë “Pastrimi” apo “Hidrogjenin Jugor”. Sepse kur po është opinioni i pamodifikuar nuk kemi çka diskutojmë. Unë personalisht kam interes që të diskutojmë financimin e OJQ-ve nga organizatat buxhetore, pasi që auditori aty kishte konstatuar disa të gjetura. Sipas raportit ka të gjetura jashtëzakonisht të mëdha.

## *Përfundim*

*Komisioni vendosi që Raporti i auditimit të performancës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare”, të diskutohet në mbledhjen e radhës së komisionit.*

*Mbledhja e radhës u vendos të mbahet më 21 korrik 2021, me fillim nga ora 10:00.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,  
Kryetare e Komisionit

---